

Presioni i Beogradit ndaj serbëve në Kosovë, Kurti: Kurrë s'ka pasur më shumë kërcënime dhe shantazhe




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PËRPLASJA MES DY LIGJEVE QË PO I BLOKON INVESTIMET NË KOSOVË



Një pronë është gjëja e parë që duhet ta sigurojë dikush kur vendos të investojë në Kosovë. Por, kur ajo është e shtetit, situata bëhet e ndërlikuar. Një përplasje mes Ligjit

për Pyjet dhe Ligjit për Pronën Publike ka krijuar një ngërç institucional në Kosovë, duke e bërë të vështirë marrjen në shfrytëzim të pronave shtetërore - dhe duke vonuar

projektet investuese. Të dyja ligjet u miratuan nga legjislatura e tetë e Kuvendit të Kosovës në vitin 2023, me një diferencë prej rreth shtatë muajsh

AKTUALE



KE-ja UA NDAN RRETH 160 MILIONË EURO SHQIPËRISË, MAQEDONISË SË VERIUT DHE MALIT TË ZI NGA PLANI I RRRITJES

F. 2

HAMZA: QEVERISJEN TONË E DORËZUAM ME KOSOVËN SHITET TË PAVARUR E INSTITUCIONE STABILE, NË GJASHTË VITET E FUNDIT VETËM REGRES

F. 3

EKONOMI



KEDS-i GJOBITET 40 000 EURO PËR NJEHSORËT

F. 8

QEVERIA ME PAKETË EMERGJENTE NË FUSHËN E MBETURINAVE

F. 8

SPORT



DUKAGJINI DHE FERIZAJ SONTË PËRBALLEN NË FINALEN E KUPËS SË KOSOVËS

F. 24



FORMOHET GRUPI PUNUES PËR PENSIONIMIN E PARAKOHSHËM NË POLICINË E KOSOVËS

F. 3

ZGJEDHJE 'INTERESANTE!'

F. 7



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mok: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

KE-ja UA NDAN RRETH 160 MILIONË EURO SHQIPËRISË, MAQEDONISË SË VERIUT DHE MALIT TË ZI NGA PLANI I RITJES

BRUKSEL, 20 MAJ - Komisioni Evropian (KE) ua ka ndarë në total 158.9 milionë euro nga ndihma financiare e Planit të Rritjes Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi të mërkurën, teksa vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, ngelin mbrapa.

Nga ky këst - i treti për këto vende - Shqipërisë i janë ndarë 49 milionë euro, Malit të Zi 44.2 milionë euro, ndërsa Maqedonisë së Veriut 65.7 milionë euro. Kjo pagesë lidhet me periudhën e tretë gjashtëmujore të raportimit, e cila përfshin reformat e zbatuara deri në fund të dhjetorit 2025.

Sipas njoftimit të Komisionit Evropian, pagesa vjen pas kërkesës për ndarjen dhe vlerësimin pozitiv të komisionit për hapat reformues të ndërmarrë në fushën e konkurrencës së biznesit dhe inovacionit në Shqipëri dhe Mal të Zi, si dhe në fushën e arsimit dhe digjitalizimit në Maqedoninë e Veriut. "Me lirim e sotëm të fondeve, shumata totale e miratuar në kuadër të Instrumentit, brenda paketave përkatese financiare, arrin në 212.8 milionë euro për Shqipërinë, 89.3 milionë euro

për Malin e Zi dhe 142.1 milionë euro për Maqedoninë e Veriut", thuhet në njoftimin e Komisionit Evropian.

Në Komisionin Evropian shpjeguan se një pjesë e këtyre mjeteve financiare të disbursuara për të tri vendet do të transferohet në buxhetet shtetërore, ndërsa pjesa tjetër u kushtohet projekteve investime përmes Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor, në përputhje me procedurat në fuqi të miratimit.

Fondet e destinuar për Kornizën e Investimeve për Ballkanin Perëndimor, pasi të miratohen nga bordi drejtues, do të mbështesin projekte infrastrukturore në fushat e transportit të qëndrueshëm, energjisë së pastër, zhvillimit digjital dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor.

Plani i Rritjes përfaqëson paketën më ambicioze financiare të Bashkimi Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Pakaja - për periudhën 2024-2027 - është në vlerë të 6 miliardë eurove. Fondet u ndahen vendeve të rajonit pjesërisht në formë grantesh dhe pjesërisht përmes kredive të

favorshme.

Qëllimi i planit është integrimi i partnerëve në tregun unik të BE-së, përmirësimi i bashkëpunimit ekonomik rajonal, thellimi i reformave të lidhura me BE-në dhe rritja e financimit të paraanëtarësimi. Kjo, nga ana tjetër, pritet ta përshejtojë procesin e zgjerimit dhe ta nxisë rritjen ekonomike të partnerëve.

Kosova, Bosnja dhe Serbia

Bosnjë-Hercegovina është vendi i vetëm që nuk ka marrë asnjë pagesë nga Plani i Rritjes deri më tani, sepse ende nuk e ka miratuar agjendën e reformës.

Kosova, në anën tjetër, e pranoi pagesën e parë muajin e kaluar. Pra, ajo mori 61.8 milionë euro parafinancim, pasi vendi dorëzoi dokumentet e nevojshme në KE dhe ratifikoi marrëveshjet e lidhura me këtë plan. Megjithatë, Kosova ka ngelur mbrapa në bërjen e reformave të nevojshme dhe tani ka shumë punë për ta zënë hapin, në mënyrë që t'i plotësojë kushtet për pagesat e radhës.

Shuma prej 61.8 milionë eurosh e parafinancimit, sipas BE-së,



është 7 për qind e totalit prej 882.6 milionë eurosh grante dhe kredi me kushte të favorshme për Kosovën në kuadër të Planit të Rritjes Ekonomike.

Kosova është zotuar se do të zbatojë 111 hapa reformash, që përfshijnë fusha sikurse sundimi i ligjit, qeverisja, zhvillimi ekonomik, tranzicioni i gjelbër dhe ai digjital, si dhe kapitali njerëzor.

Sipas BE-së, afati i parë për 13 hapa të reformave - që kapin vlerën e 90.8 milionë eurove - është deri më 30 qershor të këtij viti. Ndërsa në fund të këtij viti do të jetë afati i fundit për 27

hapa të tjera që kapin vlerën e 165.9 milionë eurosh.

Ndërkohë, Serbia, përveç të ashtuquajturit parafinancim që arrin në shtatë për qind të totalit të fondeve të ndara, deri më tani ka marrë një pagesë - gjysmën e shumës së planifikuar, pasi nuk i ka përmbushur të gjitha reformat e parashikuara deri në afatin e caktuar.

Komisioni Evropian po vlerëson nëse Serbia i plotëson kriteret për pagesa të mëtejshme, pasi ajo miratoi ligje në janar që, sipas zyrtarëve të Brukselit, e "kufizojnë pavarësinë e gjyqësorit".

SHBA-ja DHE IZRAELI PLANIFIKUAN TA VENDOSNIN AHMADINEJADIN SI UDHËHEQËS IRANIAN

UASHINGTON, 20 MAJ - Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli hynë në luftë kundër Iranit me qëllim që ta zëvendësonin udhëheqjen e regjimit me ish-presidentin e ashpër Mahmoud Ahmadinejad, raportoi "The New York Times".

Duke cituar zyrtarë amerikanë që u informuan për "planin e guximshëm", gazeta tha se gjërat "shpejt shkuan keq" dhe "vendndodhja dhe gjendja aktuale e Ahmadinejadit janë të panjohura".

Pas vrasjes së Ajatollah Ali Khamenei, presidenti i ShBA-së, Donald Trump, tha me vete se do të ishte më mirë që "dikush nga brenda" Iranit ta merrte kontrollin e vendit, raportoi "Times". "Të thuash se Ahmadinejad ishte një zgjedhje e pazakontë do të ishte një nënvlerësim i madh", tha gazeta. "Ndërsa ai ishte përplasur gjithnjë e më shumë me udhëheqësit e regjimit dhe ishte vënë nën vëzhgim të ngushtë nga autoritetet iraniane, ai ishte i njohur gjatë mandatit të tij si president, nga viti 2005 deri në vitin 2013, për



thirrjet e tij për të 'fshirë Izraelin nga harta'. Ai ishte një mbështetës i fortë i programit bërthamor të Iranit, një kritik i ashpër i Shteteve të Bashkuara dhe i njohur për shtypjen e dhunshme të mospajtit të brendshëm".

Megjithatë, gazeta vuri në dukje se në një intervistë të vitit 2019, Ahmadinejad vlerësoi presidentin Trump dhe argumentoi për një afrim midis Iranit dhe ShBA-së. "Trumpi është një njeri i veprimit. Ai është një biznesmen dhe për këtë arsye është i aftë të

llogarisë kosto-përfitimet dhe të marrë një vendim. Ne i themi atij, le t'i llogarisim kosto-përfitimet afatgjata të dy kombeve tona dhe të mos jemi të shkurtërpamës", citohet të ketë thënë Ahmadinejad.

"The Times" tha se Trumpi po shijonte suksesin e forcave speciale që rrëmbyen udhëheqësin venezuelas Nicolas Maduro dhe gatishmërinë e zëvendësës së tij të perkohshme, Delcy Rodriguez, për të punuar me Shtëpinë e Bardhë, dhe besonte se i njëjti model mund të

replikohej në Iran. Megjithatë, plani ShBA - Izrael, për të cilin Ahmadinejad ishte konsultuar, "shpejt shkoi keq", sipas zyrtarëve amerikanë që folën me "Times".

Ahadinejad thuhet se u plagos në ditën e parë të luftës nga një sulm izraelit në shtëpinë e tij në Teheran, i cili kishte për qëllim ta lironte atë nga arresti shtëpiak, thanë zyrtarët amerikanë për "Times". Ata thanë se Ahmadinejad i mbijetoi sulmit, por pas atij që pothuajse dështoi, ai ndryshoi mendje për planin e ndryshimit të regjimit dhe që atëherë nuk është gjetur më.

Një artikull në "Atlantic" në mars tha se sulmi ndaj shtëpisë ishte "në fakt një operacion arratisjeje nga burg", duke cituar bashkëpunëtorë anonimë të Ahmadinejadit. Pas këtij artikulli, "Times" tha se mori konfirmim nga një bashkëpunëtor i Ahmadinejadit se ai e njihje sulmin ajror si një përpjekje për ta liruar atë.

Bashkëpunëtori tha se amerikanët besonin se Ahmadinejad mund ta

drejtonte vendin dhe kishte aftësinë për ta menaxhuar "situatën politike, sociale dhe ushtarake të Iranit".

Por, megjithëse Ahmadinejadi arriti t'i shpëtonte arrestit shtëpiak pavarësisht prej lëndimeve të tij, gazeta tha se ai u zhgënjye nga plani i ndryshimit të regjimit dhe ndaloi së bashkëpunuari.

Ahadinejadi, i cili ishte president nga viti 2003 deri në vitin 2013, u bë gjithnjë e më shumë në kundërshtim me Udhëheqësin Suprem Ajatollah Ali Khamenei. "Ahmadinejadi është përplasur me udhëheqësit e regjimit, duke i akuzuar ata për korrupsion dhe kanë qarkulluar thashetheme rreth besnikërisë së tij. Ai u shkualifikua nga zgjedhje të shumta presidenciale, ndihmësit e tij u arrestuan dhe lëvizjet e zotit Ahmadinejad u kufizuan gjithnjë e më shumë në shtëpinë e tij. Njerëz të afërt me z. Ahmadinejad janë akuzuar se kanë lidhje shumë të ngushta me Perëndimin, ose madje spiunojnë për Izraelin", tha "Times".

HAMZA: QEVERISJEN TONË E DORËZUAM ME KOSOVËN SHTET TË PAVARUR E INSTITUCIONE STABILE, GJASHTË VITET E FUNDIT VETËM REGRES

PRISHTINË, 20 MAJ - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës dhe kandidati për kryeministër, Bedri Hamza, ka deklaruar se qytetarët e Kosovës meritojnë rezultate konkrete, zhvillim dhe më shumë shpresë për të ardhmen e vendit.

Hamza ka theksuar se PDK-ja e kishte dorëzuar qeverisjen e Kosovës shtet të pavarur, me autostrada moderne,



institucione stabile dhe partneritete të fuqishme me aleatët ndërkombëtarë. "Shtetin e kemi ndërtuar bashkë. Kemi ndërtuar polici dhe ushtri që sot janë shembull për rajonin", ka deklaruar Hamza. Ai e ka kritikuar qeverinë aktuale për mungesë rezultatesh konkrete gjatë gjashtë viteve të fundit, duke thënë se qytetarët kanë të drejtë të kërkojnë përgjigje për

gjendjen aktuale në vend. Sipas Hamzës, Kosova nuk mund të ecë përpara me fajësime, arsyetime dhe kriza të njëpasnjëshme politike, ndërkohë që shumë familje po përballen çdo ditë me çmime të larta dhe vështirësi ekonomike. "Qytetarët meritojnë rezultate. Meritojnë zhvillim. Meritojnë shpresë. Koha për ndryshim është tani", ka përfunduar Hamza në mesazhin e tij.

FORMOHET GRUPI PUNUES PËR PENSIONIMIN E PARAKOHSHËM NË POLICINË E KOSOVËS

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 MAJ - Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka njoftuar se është themeluar grupi punues që do t'i hartojë modalitetet për programin e pensionimit të parakohshëm në Policinë e Kosovës. Sipas Sveçlës, grupi punues do t'i analizojë aspektet ligjore, financiare dhe organizative të këtij procesi dhe deri në fund të muajit korrik do të dalë me propozime konkrete. "Sot, me vendim, kam themeluar grupin punues i cili, duke analizuar të gjitha

aspektet e nevojshme ligjore, financiare dhe organizative, deri në fund të muajit korrik të këtij viti do të propozojë modalitetet e programit të pensionimit të parakohshëm në Policinë e Kosovës. Grupi punues i cili sot mbajti takimin e parë, do të organizojë konsultime, takime pune dhe sesione dëgjimore me strukturat organizative të Policisë së Kosovës në nivel qendror dhe lokal, me qëllim të identifikimit të sfidave operative dhe nevojave reale që ndërlihdhen me pensionimin e parakohshëm. Në kuadër të kësaj analize, do të shqyrtohet



mundësia e zbatimit gradual të programit, duke filluar nga moshë 63 vjeç dhe duke u ulur

progresivisht deri në moshën 55 vjeç, në përputhje me kapacitetet financiare dhe

nevojat institucionale", ka thënë Sveçla.

Ai ka theksuar se ky proces synon të krijojë mundësi për një menaxhim më të mirë të burimeve njerëzore, ta rrisë efikasitetin operacional dhe të kontribuojë drejtpërdrejt në forcimin e sigurisë publike në vendin tonë. "Përmes këtij programi do të ndërtojmë një polici më funksionale, më të balancuar në strukturë dhe më të gatshme për t'iu përgjigjur sfidave bashkëkohore të sigurisë, duke respektuar njëkohësisht kontributin dhe dinjitetin e secilit zyrtar policor", ka deklaruar Sveçla.

POLICIA E KOSOVËS MERR PJESË NË 'CAPITAL POLICING EUROPE CONFERENCE 46TH'



PRISHTINË, 20 MAJ - Dy zyrtarë të lartë të Policisë së Kosovës, nënkolonel Fatos Haziri, shef i Hetimeve Rajonale në DRP Prishtinë dhe major Bekim Bislimi, drejtor i Policisë së Kryeqytetit, po marrin pjesë në konferencën ndërkombëtare 'Capital Policing Europe Conference 46th' e cila po mbahet në Helsinki. Kjo konferencë mbledh përfaqësues të institucioneve të sigurisë dhe agjencive të zbatimit të ligjit nga vende të ndryshme të Evropës dhe më gjerë, me fokus diskutimi temat më aktuale që ndërlihdhen

me sigurinë publike dhe sfidat globale të sigurisë.

Gjatë punimeve të konferencës po trajtohen çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me luftimin e krimin të organizuar, terrorizmit, trafikimit të narkotikëve, krimin kibernetik, si dhe menaxhimin e kërcënimeve dhe rreziqeve bashkëkohore ndaj sigurisë publike.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të Policisë së Kosovës në këtë konferencë ndërkombëtare është dëshmi e përkushtimit institucional për ngritjen

profesionale, forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar policor dhe shkëmbimin e përvojave me partnerët ndërkombëtarë në funksion të avancimit të sigurisë dhe rendit publik.

Përmes pjesëmarrjes në aktivitetet të tilla profesionale, Policia e Kosovës vazhdon të kontribuojë në fuqizimin e kapaciteteve të saj profesionale dhe në thellimin e bashkëpunimit me institucionet homologe ndërkombëtare në adresimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë.

Haxhiu vizitoi Ministrinë e Mbrojtjes, diskutohet për forcimin e kapaciteteve mbrojtëse

PRISHTINË, 20 MAJ - Ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, mirëpriti në takim u. d. presidenten e Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, ku riafirmuan përkushtimin institucional për forcimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe avancimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës. Gjatë takimit ministri

Maqedonci paraqiti të arriturat përgjatë mandatit, duke veçuar katërfishimin e investimeve në mbrojtje, dyfishimin e numrit të ushtarakëve si dhe zgjerimin e mundësive për shkollimin e oficerëve të FSK-së në akademitë më prestigjioze ushtarake në botë.

Po ashtu, u diskutua për situatën e sigurisë, kontributin

e Kosovës në sigurinë globale, mbështetjen për Ukrainën, zbatimin humanitar në Gaza si dhe aspiratën strategjike për anëtarësim në NATO.

Bashkëbiseduesit confirmuan se vetëqëndrueshmëria, zhvillimi i mbrojtjes gjithëpërfshirëse dhe avancimi i industrisë së mbrojtjes mbeten prioritetet strategjike për Republikën e Kosovës.





PËRPLASJA MES DY LIGJEVE QË PO I BLOKON INVESTIMET NË KOSOVË

PRISHTINË, 20 MAJ - Një pronë është gjëja e parë që duhet ta sigurojë dikush kur vendos të investojë në Kosovë. Por, kur ajo është e shtetit, situata bëhet e ndërlikuar. Një përplasje mes Ligjit për Pyjet dhe Ligjit për Pronën Publike ka krijuar një ngërç institucional në Kosovë, duke e bërë të vështirë marrjen në shfrytëzim të pronave shtetërore - dhe duke vonuar projektet investuese. Të dyja ligjet u miratuan nga legjislatura e tetë e Kuvendit të Kosovës në vitin 2023, me një diferencë prej rreth shtatë muajsh.

Si është problemi?

Ligji për Pyjet, i miratuar më 9 mars 2023, i jep Agjencisë Pyjore të Kosovës (APK) kompetencën për menaxhimin e kullotave dhe të tokave pyjore shtetërore, rrjedhimisht t'i shqyrtojë edhe kërkesat për t'i marrë tokat shtetërore me qira. Sipas këtij ligji, deri në 20 hektarë të tokës pyjore jepen me qira me miratim të Agjencisë. Për 20 deri në 50 hektarë vendos Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHHR), kurse mbi 50 hektarë jepen vetëm me vendim të Qeverisë së Kosovës. Por, pas miratimit të Ligjit për Pronën Publike, më 26 tetor të po atij viti, situata u bë e paqartë. Ky ligj parasheh që pëlqimin paraprak për ta marrë një pronë në shfrytëzim

ta japë Zyra për Administrimin e Pronës Publike (ZAPP). Ky organ tashmë është krijuar si zyrë e veçantë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Vetëm pasi ZAPP-ja të jetë siguruar se prona që po kërkohet nga një investitor potencial nuk është në interes për t'u përdorur nga asnjë institucion publik, i vazhdon procedurat e dhënies me qira të saj.

Këto procedura përfundojnë me miratimin final nga institucionet e larta të shtetit. Sipas këtij ligji, prona shtetërore mund të jepet me qira deri në 15 vjet, me vendim në mbledhjen e Qeverisë apo të kuvendeve komunale. Kurse për dhënien me qira për 99 vjet të një prone publike duhet të vendosë Kuvendi i Kosovës.

Çfarë shkaktoi kjo?

Për shkak të mungesës së harmonizimit ligjor, APK-ja ka pezulluar shqyrtimin e kërkesave për shfrytëzim të përkohshëm të tokave publike. Në një përgjigje zyrtare të Agjencisë për kërkesën e një investitori të huaj të interesuar - të cilën e ka siguruar Radio Evropa e Lirë - thuhet se pa u bërë një qartësim ligjor rreth kompetencave, ajo nuk mund të vazhdojë me procedurat. "E kemi të pamundur të vazhdojmë me procedura të

mëtejme pa u marrë veprimet për plotësimin/ndryshimin dhe harmonizimin ligjor, dhe cilat mund të jenë kompetencat që ka Agjencia Pyjore e Kosovës lidhur me menaxhimin dhe administrimin e pyjeve, kullotave, dhe tokave pyjore publike në Republikën e Kosovës", thuhet në përgjigjen e APK-së, të datës 19 mars 2025.

Tash e një vit, investitori potencial nuk ka arritur të marrë me qira pronën shtetërore të kërkuar. Disa investitorë të huaj të interesuar, me të cilët bisedoi Radio Evropa e Lirë, u ankuan për pritje të gjata në shqyrtimin e kërkesave për marrje me qira të pronave publike, por hezituan të flasin publikisht për rastet e tyre, nga frika se kjo mund t'u krijojë probleme në procesin e marrjes së pronës në shfrytëzim.

APK-ja i tha Radios Evropa e Lirë se në lidhje me atë se si po veprohet me kërkesat në pritje të investitorëve duhet të pyetet MBPZH-ja. Por, as kjo e fundit nuk u përgjigj. Ndërkaq, Zyra e Kryeministrit i tha Radios Evropa e Lirë se ZAPP-ja, si njësi e re e krijuar, ka trajtuar secilën kërkesë që i është përcjellë nga APK-ja, duke shtuar se "involvimi i Agjencisë së Pyjeve brenda kësaj teme është i pashmangshëm". Në përgjigje thuhet edhe se Qeveria ka zhvilluar takime

mes institucioneve, përfshirë APK-në dhe bizneset që shfrytëzojnë tokë pyjore me qira, për të sqaruar paqartësitë ligjore dhe për të mbrojtur interesin publik.

Dekurajim për investitorët e huaj

Në praktikë kjo situatë ka krijuar vonesa të mëdha për bizneset që synojnë investime në prona publike. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, thotë se pezullimi i shqyrtimit të kërkesave po i lë investitorët në pasiguri. "Nuk ka ndonjë kufi që është i vendosur brenda të cilit kthehet përgjigja. Ka biznese që po presin që shtatë muaj e deri në një vit, dhe nuk kanë ende përgjigje, për shkak të këtyre paqartësive", tregon ai për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, kjo situatë po i dekurajon investitorët e huaj të zhvillojnë biznes në Kosovë. "Kemi investitorë të huaj që kanë ardhur ta bëjnë një studim për investim potencial dhe menjëherë kanë hasur në këtë sfidë ligjore. Dhe, në njëfarë forme, kjo i ka bërë të pasigurt që ata të investojnë në Kosovë", thotë Rafuna.

Shembulli i Shqipërisë

Nikolin Jaka, kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë, thotë për Radion Evropa e Lirë se edhe në Shqipëri ka pasur raste kur investimet vendëse dhe të

huaja janë shtyrë për shkak të moskoordinimit institucional, por që është punuar në mënjanimin e pengesave përmes digjitalizimit të shërbimeve.

Pavarësisht kuadrit ligjor të konsoliduar, bizneset në Shqipëri vazhdojnë të kërkojnë më shumë qartësi rreth konceptit "one-stop authority" për dhënien në përdorim të pronës publike, tregon ai.

Sipas këtij koncepti, një investitor në Shqipëri mund të kryejë disa procedura administrative në një zyrë të vetme, pa pasur nevojë të shkojë në shumë institucione. Jaka pohon se Shqipëria sot është vend i favorshëm për investime, teksa përmend se "nuk ka kufizime të mëdha për kapitalin e huaj". "Kostot konkurruese të punës dhe procedurat më të avancuara digjitale për regjistrimin e biznesit dhe licencimet", por edhe "pozicionin strategjik" të Shqipërisë dhe "afërsinë me tregun e Bashkimit Evropian" ai i numëron si lehtësira të tjera. "Në terma praktikë, investitori në Shqipëri sot mund të regjistrojë biznesin relativisht shpejt edhe online", shprehet Jaka.

Ndërkohë, investitorët në Kosovë duhet të presin edhe më tutje një qartësim ligjor për të shfrytëzuar pronat publike - vendi aktualisht nuk ka një qeveri me kompetenca të plota, dhe as Kuvend që mund të miratojë ndryshime të ligjeve.

IKD-ja PADIT KUVENDIN PËR NDËRHYRJE NË MANDATIN E KOMISIONIT PËR DHËNIEN E PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS

PRISHTINË, 20 MAJ - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka dorëzuar padi në Gjykatën Administrative të Republikës së Kosovës kundër Kuvendit të Republikës së Kosovës, përmes së cilës ka kërkuar anulimin e Vendimit nr. 10-V-276/1, të datës 27 prill 2026, lidhur me ndërprerjen para kohe të mandatit të Komisionit për dhënie e Provimit të Jurisprudencës. Përmes kësaj padie IKD-ja kundërshton mënyrën se si Kuvendi ka ndërprerë mandatit e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës, i cili, sipas Ligjit nr. 08/L-033 për Provimin e Jurisprudencës, kishte mandat trevjeçar deri më 15 dhjetor 2026.

Në padi thuhet se vendimi i Kuvendit është i kundërligjshëm dhe arbitrar, pasi që përmes tij është shfuqizuar vendimi paraprak për emërimin e Komisionit dhe është zëvendësuar e tërë përbërja e tij pa asnjë bazë të qartë ligjore, pa procedurë të rregullt dhe pa arsyetim juridik. Sipas IKD-së, Ligji për Provimin e Jurisprudencës i jep Kuvendit kompetencë vetëm për emërimin e anëtarëve të Komisionit, por nuk parasheh kompetencë për ndërprerjen e mandatit të tyre para kohe. Në padi



theksohet se mungesa e dispozitave ligjore për shkarkim apo ndërprerje të mandatit nuk mund të interpretohet si autorizim për ndërhyrje arbitrare në mandatit e një organi të pavarur profesional. Specifikisht, në padi, ndër të tjera, potencohet se "kompetenca për emërim nuk e përfshin automatikisht edhe kompetencën për ndërprerje të mandatit para kohe. Sikur ligjvënësi të kishte synuar t'i jepte Kuvendit të drejtën për shkarkimin apo zëvendësimin e përbërjes së Komisionit gjatë mandatit, këtë do ta kishte përcaktuar

shprehimisht në ligj duke përcaktuar bazat, procedurën dhe standardet për ushtrimin e kësaj kompetence. Kjo qasje është ndjekur në legjislacionin që rregullon organe të tjera të pavarura". Po ashtu, IKD-ja në padi ka theksuar se vendimi i kontestuar nuk përmban asnjë arsyetim lidhur me nevojën për ndërprerjen e mandatit të Komisionit ekzistues, nuk identifikon asnjë shkelje konkrete nga ana e anëtarëve të Komisionit dhe nuk jep asnjë shpjegim mbi bazën ligjore që ka shërbyer për zëvendësimin e tij para

përfundimit të mandatit ligjor. Në këtë drejtim, IKD-ja konsideron se vendimi i Kuvendit është nxjerrë edhe në kundërshtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi mungon arsyetimi juridik dhe faktik i aktit administrativ, duke cenuar parimet e ligjshmërisë, sigurisë juridike dhe pritshmërive legjitime. Për më tepër, IKD-ja në padi ka theksuar se kjo mënyrë e veprimit krijon precedent të rrezikshëm institucional, pasi nënkupton se mandatet e organeve profesionale të emëruara me ligj mund të

ndërpriten në çdo kohë pa kriteret e qarta ligjore dhe pa procedurë të rregullt.

IKD-ja, gjithashtu, ka rikujtuar standardin e vendosur nga Gjykata Kushtetuese në rastin KO127/21, lidhur me shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas të cilit mandatet e organeve të pavarura nuk mund të ndërpriten në mënyrë kolektive dhe pa arsyetim konkret individual.

Në padi, IKD-ja ka vlerësuar se Provimi i Jurisprudencës paraqet mekanizëm me rëndësi të veçantë për sistemin e drejtësisë, pasi ndikon drejtpërdrejt në vlerësimin profesional të juristëve që synojnë ushtrimin e funksioneve kyçe në sistemin gjyqësor dhe juridik në Republikën e Kosovës. Për këtë arsye, sipas IKD-së, përbërja dhe funksionimi i Komisionit duhet të mbështeten në parimet e pavarësisë, stabilitetit institucional dhe ligjshmërisë. Përmes kësaj padie, IKD-ja i ka propozuar Gjykatës Administrative që ta aprovojë padinë si të bazuar dhe ta anulojë Vendimin nr. 10-V-276/1 të Kuvendit të Republikës së Kosovës si të kundërligjshëm.

PRESIONI I BEOGRADIT NDAJ SERBËVE NË KOSOVË, KURTI: KURRË S'KA PASUR MË SHUMË KËRCËNIME E SHANTAZHE

PRISHTINË, 20 MAJ - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka thënë se terrorin që është duke e bërë Beogradi mbi serbët e Kosovës e kanë dëshmuar vetë serbët me ankesa, derisa shtoi se asnjëherë më parë s'ka pasur më shumë kërcënime e shantazhe sikurse tani. Këto deklarata Kurti i ka bërë në një konferencë për medie kur është pyetur lidhur me arrestimin e gjashtë serbëve të Graçanicës, të dyshuar për presion, të martën. "Unë besoj se fjala e ministrit për Komunitete dhe Kthim në mbledhjen e qeverisë mbi trysninë e madhe që po ushtrohet ndaj serbëve të Kosovës, që patjetër ta votojnë Listën Serbe dhe askënd tjetër, si dhe masat që po i ndërmerren Serbia, duke

përfshirë edhe përcjelljen e rrjeteve sociale të secilit zyrtar shtetëror, të secilës figurë publike dhe të secilit politikan serb, janë vërtet alarmuese", ka shtuar Kurti. Kurti ka shtuar se "ky lloj presioni që po e bën Beogradi zyrtar mbi serbët e Kosovës e kemi të dëshmuar edhe nga vetë ankesat e tyre. Ky fenomen ka marrë përmasa të mëdha prej kohës që unë jam kryeministër. Kurrë nuk ka pasur më shumë kërcënime e shantazhe. Në anën tjetër ju e dini që Serbia vazhdimisht mundohet të ketë elemente të saj që të krijojë dualizma brenda territorit tonë të Republikës dhe ato janë veprime ilegale në shtetin tonë të pavarur", ka shtuar Kurti.



Nga 3 000 në 500 euro, Vitia nënshkruan udhëzimin e ri administrativ për specializime

PRISHTINË, 20 MAJ - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka njoftuar se ka nënshkruar Udhëzimin Administrativ për shkollimin specialistik, duke paraqitur tri politika të reja për profesionistët shëndetësorë. Sipas Vitisë, ndryshimet përfshijnë uljen e tarifës për specializim për qytetarët nga viset shqiptare, mbështetje për

specializantet në pushim të lehonisë dhe ndryshim të kriterëve për përvojën e punës. "Sot kam nënshkruar Udhëzimin Administrativ për shkollimin specialistik, me tri politika të reja në mbështetje të profesionistëve shëndetësorë", ka shkruar Vitia.

Ai bëri me dije se kandidatët nga viset shqiptare, të cilët deri

më tani paguanin 3 000 euro në vit për specializim, tashmë do të paguajnë 500 euro, sa edhe qytetarët e Kosovës. "Qytetarët nga të gjitha viset shqiptare, që deri tash kanë paguar 3000 euro në vit për specializim, tash do të paguajnë vetëm 500 euro, njëjtë si qytetarët e Republikës së Kosovës", thuhet në njoftim. Një tjetër ndryshim lidhet me

specializantet që janë në pushim të lehonisë. "Për herë të parë, specializanteve që do të jenë në pushim të lehonisë do t'u vazhdohet pagesa pas kthimit në specializim", ka theksuar Vitia.

Po ashtu, ministri në detyrë njoftoi se përvoja njëvjeçare e punës nuk do të jetë më kriter eliminues, por vetëm kriter poentues në procesin e



specializimit. "Përvoja njëvjeçare e punës tashmë do të jetë vetëm kriter poentues", ka bërë me dije ai.

NË MAQEDONINË E VERIUT, IDENTITETI KOMBËTAR MBROHET NGA GJUHA SHQIPE E JO NGA PËRKATËSIA FETARE



Shkruan: Ibrahim GASHI

Për shqiptarët në Maqedoninë e Veriut gjuha shqipe ka qenë historikisht elementi themelor i identitetit kombëtar më shumë sesa përkatësia fetare. Kjo nuk nënkupton se feja nuk ka rëndësi, por se gjuha ka shërbyer si ura që ka bashkuar shqiptarët përtej dallimeve fetare, politike dhe krahinore. Shqiptarët janë një nga popujt e rrallë në Ballkan ku identiteti kombëtar është ndërtuar kryesisht mbi gjuhën dhe kulturën, e jo mbi attribute të tjera e as mbi fenë. Brenda kombit shqiptar bashkëjetojnë myslimanë, katolikë dhe ortodoksë, por të gjithë ndajnë të njëjtën gjuhë, histori dhe trashëgimi kulturore. Pikërisht kjo ka bërë që gjuha shqipe të jetë simboli

më i fortë i unitetit kombëtar. Në Maqedoninë e Veriut, ruajtja dhe përdorimi i gjuhës shqipe ka qenë një betejë politike dhe kulturore për dekada. Të drejtat për arsimim në shqip, përdorimin institucional të gjuhës dhe përfaqësimin kulturor nuk kanë qenë vetëm çështje komunikimi, por çështje ekzistence dhe dinjiteti kolektiv. Një komunitet mund të ndryshojë bindje fetare gjatë historisë, por humbja e gjuhës shpesh nënkupton humbjen graduale të identitetit kombëtar. Rilindësit shqiptarë e kanë kuptuar këtë shumë herët. Motoja e famshme "Feja e shqiptarit është shqiptaria", e lidhur me Pashko Vasa, shpreh

pikërisht idenë se mbijetesa kombëtare e shqiptarëve varej nga uniteti përmes gjuhës dhe kulturës, jo nga ndarjet fetare. Në një rajon ku feja shpesh është përdorur si instrument politik për ndarje etnike, shqiptarët kanë mbijetuar si komb sepse kanë ruajtur gjuhën. Sot, për shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, gjuha shqipe mbetet themel i arsimit, kulturës, identitetit dhe pjesëmarrjes së barabartë në shtet. Ajo është kujtesë historike, mjet emancipimi dhe garanci për vazhdimësinë kombëtare. Feja është çështje personale dhe shpirtërore; gjuha është trashëgimi kolektive dhe shtylla që mban gjallë identitetin e një populli.

IKShPK-ja: 17 RASTE ME FRUTH JANË KONFIRMUAR NË KOSOVË, TË GJITHË TË PAVAKSINUAR

PRISHTINË, 20 MAJ - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka njoftuar se nga 16 prilli deri më 20 maj 2026 janë konfirmuar 17 raste me fruth në Kosovë. Sipas të dhënave të publikuara nga IKShPK-ja, numri më i madh i rasteve është regjistruar në Ferizaj, gjashtë raste, pasuar nga Prishtina me katër raste dhe Kaçaniku me tri raste. Nga një rast është raportuar edhe në Lipjan, Fushë-Kosovë, Gjilan dhe Shtime. Instituti thekson se të gjitha

rastet e konfirmuara kanë qenë te personat e pavaksinuar me vaksinën MMR kundër fruthit, shtave dhe rubellës. "Të gjitha rastet e konfirmuara janë të pavaksinuar me vaksinën MMR si dhe kanë marrë trajtim spitalor, që dëshmon për potencialin serioz të komplikimeve të mundshme që mund të shkaktojë fruthi", thuhet në njoftim.

IKShPK-ja u ka bërë thirrje urgjente prindërve t'i kontrollojnë kartelat e



vaksinimit të fëmijëve dhe ta kryejnë vaksinimin në qendrat e mjekësisë familjare. "Duke marrë parasysh natyrën shumë ngjitëse të

fruthit dhe rrezikun për përhapje të mëtejshme, IKShPK u bën thirrje urgjente prindërve që të kontrollojnë kartelën e vaksinimit të fëmijëve të tyre", thuhet më tej.

Instituti ka rekomanduar shmangien e kontakteve me persona që shfaqin simptoma si temperaturë e lartë, skuqe në lëkurë, kollë apo rrufë, ndërsa personat me simptoma të dyshimta duhet të paraqiten menjëherë në institucionet shëndetësore.

Sipas IKShPK-së, në terren po zbatohen masa konkrete për menaxhimin e situatës, përfshirë identifikimin e fëmijëve të pavaksinuar, kontaktimin e prindërve dhe angazhimin e ekipeve mobile për vaksinim, veçanërisht në zonat me mbulueshmëri më të ulët të vaksinimit.

"Vaksinimi mbetet mënyra më efektive dhe më e sigurt për parandalimin e fruthit dhe mbrojtjen e shëndetit publik", ka rikujtuar IKShPK-ja.

Ish-nënkryetarja e LDK-së i bashkohet ekipit të Kurtit

PRISHTINË, 20 MAJ - Albin Kurti ka paraqitur në ekip Shqipe Mjekiqin, ish-nënkryetare e LDK-së. "Në ekipin tim si kryeministër, nga sot u bashkua Shqipe Mjekiqi, për të kontribuar me ekspertizën e saj në politikë të jashtme dhe marrëdhënie ndërkombëtare. Ishte kënaqësi të bashkëbisedojmë mbi nevojat e Kosovës në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE dhe

NATO, të arriturat tona socio-ekonomike dhe vlerat demokratike, zhvillimet politike në vendin tonë e në rajon dhe situatën e sigurisë. Shqipe Mjekiqi ka mbaruar studimet e doktoraturës në Shkenca Politike në Trinity College Dublin, Masterin në politikat e Bashkimit Evropian në London School of Economics dhe studimet bazë në Shkenca Politike në Universitetin e Prishtinës.

Shqipja ka një përvojë të gjatë profesionale në institucionet publike të Republikës së Kosovës në fushën e integritetit evropian dhe çështjeve të sigurisë. Aktualisht është Profesor Asistent në Kolegjin UBT dhe e angazhuar si konsulente në projekte të ndryshme që lidhen me zhvillimin dhe proceset reformuese në vendin tonë", ka shkruar Kurti në rrjetet sociale.



ZGJEDHJE 'INTERESANTE'!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Ripërtypte e ushqimit të stërpërdorur: Vetëm në raste të veçanta dëgjoj intervista të politikanëve. Janë jotërheqese dhe të pasinqerta, pa përmbajtje, mundim për tru dhe vesh. Shumica e politikanëve duket se nuk kanë lexuar asgjë që nga koha e leximit të detyruar të lekturave në shkollën fillore. Bëra zemrën gur dhe e dëgjova intervistën e KM në detyrë, Albin Kurthit, në KTV, në kohëzgjatje prej 1 ore e 44 minutave, jo drejtpërdrejt, por pasi e kishte përfunduar këtë maratonë të mashtrimeve dhe përtypte të gjellëve të të gjitha mandateve të këtij Nastradini politik. Albin Kurthi fliste sikur të ishte në studio të Radio Pekinit ku si dëgjues janë kinezët që asgjë nuk dinë për Kosovën, ekonominë e saj, gjendjen materiale dhe mjedisin social. Thuajse ne qytetarët e Kosovës jemi kinezë! Çfarë mashtruesi që driblon me fjalë dhe argumente! Çfarë alkimisti kur përpiqet që gënjeshtër dhe mashtrimin ta paraqesë si të vërtetë dhe sinqeritet! Që varfërinë ta paraqesë si begati, ikjen nga vendi shkaku i humbjes së shpresës si mundësi dhe shpresë në baustellat e shteteve të tjera. Nuk më ka ngjarë deri më sot që në një hapësirë kohore prej 1 ore e 44 minutave të dëgjoj aq shumë të pavërteta, mashtrime,

pasaktësi, shpresa të rreme, përpjekje për të arsyetuar çdo dështim, hajni, tradhti shtetërore, politike dhe kombëtare! Kur të analizohen të gjitha këto atëherë bindemi në saktësinë 100 për qind të profecive të Bacë Adem Demaçit dhe Kadri Veselit për këtë Ostap Bender të Kosovës. Albin Kurthi manipulon me shifra, tituj dhe status shoqëror, si mjet lufte kundër opozitës dhe opinionit që nuk e ka nën këmbë! Albin Kurthi me këtë "ushqim ideologjik dhe toksik" adrenalizon trutharët që e përkrahin dhe komunitetin gërmaçorë. Ai përdorë shifra të larta të të "arriturave", rezultatit zgjedhor, tituj si prof. dr. gjeneral lejtnant, "lidere e shoqërisë civile", trim me fletë, patriot etj. etj. për të impresionuar publikun. Gjatë mandatit të tij Kurthi vetëm e ka mirëmbajtur ritmin e dështimeve, varfërimin e qytetarëve dhe varfërinë e ka shndërruar në meny të mbijetesës, korrupsionin e ka bërë kategori kushtetuese të mbrojtur nga shteti, e ka ngritur në nivel të patologjisë urrejtjen ndaj luftëtarëve dhe udhëheqësve të UÇK-së, ka mbjell frymën dhe praninë antikombëtare në të gjitha institucionet duke favorizuar dhe fuqizuar klanin Surroi (Gjinovci, Gashi, Gjymshiti etj.), ka promovuar, fuqizuar dhe

përkrahur materialisht zagazimin medial, analitik dhe shoqërisë civile. Ka kapur çdo gjë që kapet e nuk kapet si askush para tij. E ka zyrtarizuar pornografinë dhe prostitucionin diplomatik duke eliminuar profesionistët me integritet kombëtar dhe politik si puna e Vebi Miftarit në Vatikan dhe ka fuqizuar llaskucët të tredhur kombëtarisht dhe politikisht si puna e Agron Bajramit nga klani Surroi në Bruksel të cilin, për më keq e ka bërë ndërmjetës për realizimin e autonomisë politike dhe territoriale të Serbisë në Kosovë përmes Marrëveshjes së Brukselit dhe aneksit (bishtit) të Ohrit që e bënë proserbi dhe projugosllavi Surroi dhe mercenari Weller. Në Maqedoni të Veriut shkatërroi shqiptarët si fuqi politike duke i shndërruar në lypësarë të autonomisë kulturore përmes degës së VMRO - DPMNE të Hristovskit me akronim VLEN. Në Luginë e zyrtarizoi vazalitetin përmes Ardita Sinanit dhe rrogëtarëve veteranë. Në Shqipëri është grupi dejonamihalist që paguhet nga buxheti i Kosovës për të punuar kundër Kosovës me Elpis Hoxhën, Hys Ferrin dhe të ngjashmit, pakicë absolute, si shurra e pulës. Mimoza Kusari, Mata Hari e LV-së e mirëmbajti hotlajnjin (linjën e kuqe antikombëtare)

me Milan Radoiçiqin dhe Sllavko Simiqin pashmangshëm me direktivat e Kurthit. Më herët thoshte se nuk ka bisedime me Serbinë pa kërkimfalje, ndriçimin e fatit të personave të zhdukur dhe kompensim për dëmet e luftës. Dhe, a i mbajti premtimet e kushtëzuara. Jo dhe asnjëherë. Tash po thotë se nuk takohet me Vuçiqin pa e dorëzuar Radoiçiqin, pa e tërhequr Serbia letrën e Bërnabiqit dërguar shteteve të BE-së dhe pa e nënshkruar Marrëveshjen e Brukselit. Riciklim i mashtrimit; të gjitha shtetet nuk kërkojnë dorëzimin e Radoiçiqit por sjelljen para drejtësisë gjë që Serbia e ka bërë duke hapur rast penal kundër tij. Hipotetiksht, nëse Radoiçiq arrestohet në cilindo shtet, në asnjë rrethanë nuk do të ekstradohet në Kosovë por në Serbi. Këtë Kurthi e dinë shumë mirë por e përdorë për vota. Edhe për Marrëveshjen e Brukselit dhe të Ohrit zotimi dhe pranimi gojor publik është i barazvlefshëm me dokument të nënshkruar. Edhe këtë Kurthi e ka shumë të qartë. Kurthi bëri përpjekje për manipulim dhe instrumentalizim të familjes Jashari. Nëse nuk e orkestroi, së paku në heshtje përkrahu linçimin e Ramush dhe Daut Haradinaj si dhe Sami Lushtakut. Maksimalisht u angazhua kundër krerëve të UÇK - së që po gjykohen në Hagë bashkë me Donika Shvarc, Lenka Haxhiu, Xhelal Sfeqla dhe pisat Hekuran Murati dhe Dimal Basha. Në mesin e shumë "margaritarëve" mashtrues.

Zgjedhjet e 7 qershorit: Kurthi po i riciklon premtimet që as nuk i ka realizuar e as që do t'i realizojë. Si risi apo xhoker për këto zgjedhje e ka formimin e xhandarmerisë, një formacion midis policisë dhe ushtrisë apo çiftëzim e Xhelal Sfeqlës me Ejup Maqedoncin. Xhela këtu është në terren të vet intelektual dhe profesional, maksimumi i maksimumit është të bëhet xhandar, është i formatizuar për këtë. Albin Kurthi ndërhyri në mënyrë brutale në konkursin për kryeprokuror të shtetit duke e

sulmuar dhe eliminuar Blerim Isufajn si kandidat me të drejta dhe mundësi të barabarta. Është dhunim flagrant i konkursit. Nëse Kurthi bashkë me servilen Haxhiu nuk arrin ta bëjë kryeprokuror të shtetit Agim Bahtirin apo Mefail Bajçinovcin atëherë do të përcaktohet midis Petrit Kryeziut dhe Shqipdonit. Të rrojmë e ta shohim. Opozita nuk duhet ta shajë Kurthin por duhet të bëjë krahasime se çka ka premtuar e çka ka realizuar në planin ekonomik, social, politik, kombëtar dhe ndërkombëtar. Opozita duhet të tregojë se Kurthi po e zbaton në vepër eutanazinë (vrasjen humane) të pensionistëve dhe kategorive sociale.

LDK-ja do të rritet ndjeshëm ndërsa rritje mund të ketë edhe PDK-së. AAK-ja e kalon pragun pa asnjë problem kurse "grushti goditës" i LV-së në luftë kundër opozitës, PSD-ja mund ta kalojë pragun vetëm me vota të LV-së. As që do të dilnin në zgjedhje nëse; "ai që e ka dhënë lekun për t'ua blerë burekun" nuk do t'i urdhëronte të garojnë në zgjedhje. Njëjtë pati vepruar me LV-në më parë. Vojsa Osmanit po ia kanë frikën andaj po e sulmojnë dhe godasin nën dhe mbi brez gra dhe "burra" të LV-së. Nëse zgjedhjet do të mbaheshin këtë të diel, opozita do të fitonte 55 - 58 vende në Kuvend. Po ka kohë deri në zgjedhje, gjërat mund të ndryshojnë.

Më herët askush nuk do të besonte se Arsenali do të bëhet kampion i Anglisë dhe Barcelona kampion i Spanjës. Po u bënë, urime për mua. Edhe në politikën kosovare mund të ndodhë kjo. Arsenali u bë kampion në saje të dështimit të Manchester City-t, Liverpoolit, Chelzit, M. Unitedit kurse Reali pësoi shkaku se po e zbaton mercenarizmin në futboll sikur dikur PSG. Edhe LV-ja mercenarizmin e ka spiritus movens. Mbape nuk e forcoi mjaftueshëm Realin, a do ta forcojë Mulla Osmani LV-në? Apo do të kontribuojë në stabilizimin e mercenarizmit sikur dikur Mesin, Neymar dhe Mbape në PSG.

Nasim Haradinaj: Më 7 qershor kam vendosur ta mbështes AAK-në

PRISHTINË, 20 MAJ - Nasim Haradinaj ka njoftuar se në zgjedhjet e 7 qershorit do ta mbështesë Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, duke treguar edhe arsyen. "Këto zgjedhje janë ndoshta ndër më të rëndësishmet në historinë tonë të pasluftës. Më 7 qershor, kam vendosur ta mbështes Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, Pse? Sepse Aleanca, si subjekt politik në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka

qenë një zë i fuqishëm opozitar. Ka qëndruar përballë çdo qeverie me argumente të forta, por njëkohësisht ka treguar konstruktivitet kur ka qenë në pyetje interesi i shtetit tonë. Aleanca, e edhe Ramushi me shokë i duhet Parlamentit të Republikës së Kosovës. Prezenca e këtij subjekti politik është garanci për vendin, për lirinë dhe për shtetin tonë. Si subjekt parlamentar janë dëshmuar se dinë të bëjnë dallimin kur duhet të jenë të

ashpër dhe të palëkundur ndaj agjendave kundër shtetit, por edhe kur duhet maturi politike dhe përgjegjësi kombëtare. Kosova ka nevojë për njerëz që e kanë dëshmuar veten në kohët më të vështira dhe që nuk janë lëkundur kurrë përballë sfidave të shtetit. Përherë dhe gjithmonë me gjithë çlirimtarët dhe ndërtuesit e mbrojtësit e shtetit e kombit!", ka shkruar në "Facebook" Nasim Haradinaj.



Zëvendësministri i Industrisë: Kosova po hyn në një fazë të re të zhvillimit ekonomik

PRISHTINË, 20 MAJ - Zëvendësministri i Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Jeton Mehmeti, ka marrë pjesë në Forumin e 3-të për Investime të Qëndrueshme, të organizuar nga Këshilli Evropian i Investitorëve në Kosovë, ku ka paraqitur vizionin dhe prioritetet e Ministrisë për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të Republikës së Kosovës. Gjatë fjalës së tij zëvendësministri Mehmeti theksoi se Kosova po hyn në një fazë të re të zhvillimit ekonomik, ku fokusi nuk është

vetëm tërheqja e investimeve, por orientimi i tyre drejt sektorëve me vlerë të shtuar si prodhimi, inovacioni, industria përpunuese, teknologjia dhe rritja e eksporteve. Ai nënvizoi se përmes reformave ekonomike, Ligji për Investime të Qëndrueshme dhe planit për zhvillimin e 14 Parqeve Industriale të Gjelbra, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit po synon krijimin e një ambienti më konkurrues dhe më atraktiv për investitorët vendorë dhe

ndërkombëtarë. Sipas tij, këto politika janë të orientuara drejt ndërtimit të një modeli të qëndrueshëm ekonomik, i cili mbështet rritjen e prodhimit vendor, forcimin e industrisë dhe zgjerimin e eksporteve të Kosovës në tregjet ndërkombëtare. Zëvendësministri Mehmeti falënderoi Këshillin Evropian të Investitorëve në Kosovë dhe drejtorin ekzekutiv, Emrush Ujkani, për organizimin e forumit dhe për kontributin e vazhdueshëm në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit privat në vend.



MINTI DHE UNIVERSITETI I PRISHTINËS DREJT BASHKËPUNIMIT PËR ZHVILLIMIN INDUSTRIAL

PRISHTINË, 20 MAJ - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, ka zhvilluar një takim me dekanin e Fakultetit të Ndërtimitarisë, prof. Florim Grajçevci, dhe udhëheqësin e Departamentit të Inxhinierisë së Ambientit, prof. Lavdim Osmanaj, në të cilin është diskutuar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike, akademisë dhe sektorit privat në funksion të zhvillimit industrial të vendit. Gjatë takimit fokus i veçantë iu kushtua nevojës për rritjen e ndërveprimit ndërmjet institucioneve dhe komunitetit akademik, me qëllim të

ndërtimit të politikave dhe projekteve zhvillimore të mbështetura në ekspertizë profesionale dhe shkencore. Ministria Kusari-Lila kërkoi mbështetjen e Fakultetit të Ndërtimitarisë dhe ekspertëve të fushës në konceptimin dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të parqeve industriale të gjelbra, të cilat synojnë të krijojnë kushte moderne për investime, rritje të prodhimit vendor dhe hapje të vendeve të reja të punës. Sipas ministres, zhvillimi i këtyre parqeve industriale do të bazohet në parimet e ekonomisë qarkore dhe në minimizimin e ndikimit në mjedis, duke krijuar model të qëndrueshëm zhvillimor për



industrinë në Kosovë. Po gjatë takimit u bë me dije se në ditët në vijim pritet të finalizohet një memorandum bashkëpunimi me Rektoratin e

Universitetit të Prishtinës, i cili do ta përfshijë Fakultetin e Ndërtimitarisë, Fakultetin e Elektroteknikës, Fakultetin e Makinerisë dhe Fakultetin e

Arkitekturës.

Përmes këtij memorandumi do të përcaktohen format konkrete të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe akademisë, me fokus në mbështetjen e projekteve zhvillimore dhe avancimin e kapaciteteve profesionale dhe teknike.

Në takim u vlerësua se një qasje e tillë krijon një bashkëpunim të ndërsjellë ndërmjet akademisë, institucioneve publike dhe sektorit privat, ku dija dhe kërkimi shkencor kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, ndërsa bizneset dhe institucionet përfitojnë nga zgjidhjet inovative dhe ekspertiza profesionale.

KEDS-I GJOBITET ME 40 000 EURO PËR NJEHSORËT



PRISHTINË, 20 MAJ - Është mbajtur mbledhja e radhës e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit, në të cilën është paraqitur edhe Draft Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit 2026-2030. Përveç pikave të rendit të ditës, në këtë mbledhje u paraqitën informata lidhur me aksionet e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, të fokusuara në monitorimin e çmimeve të derivateve,

njehsorëve elektrikë dhe produkteve të qumështit me bazë bimore në treg. Vlen të theksohet se po vazhdon procesi i verifikimit të njehsorëve elektrikë të konsumatorëve që kanë paraqitur ankesa. Vetëm gjatë dy ditëve të fundit në laboratorin e Agjencisë së Metrologjisë janë verifikuar 19 njehsorë, prej të cilëve shtatë kanë rezultuar pa afat të vlefshmërisë, ndërsa një njehsor

është konstatuar pa lejim tipi. Raportet zyrtare të laboratorit janë proceduar në Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut për ndërmarrjen e masave ligjore dhe shqiptimin e gjobave ndaj KEDS-it, në vlerë prej 40 000 eurosh. Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit ka diskutuar edhe për adresimin sa më të shpejtë të rasteve dhe mënyrat e kompensimit të dëmit ndaj

konsumatorëve. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit gjatë tre muajve të fundit ka ndërmarrë një sërë masash proaktive për trajtimin e ankesave të konsumatorëve. Si tregues i rritjes së besimit institucional të qytetarëve konsiderohet edhe rritja prej 35 % e numrit të ankesave, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Qeveria me paketë emergjente në fushën e mbeturinave

Prishtinë, 20 maj - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me ministren në detyrë të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fitore Pacolli, mbajtën konferencë për medie, në të cilën shpallën paketën e emergjencës në fushën e mbeturinave: Aksioni Kundër Mbeturinave. Kurti ka thënë se mbledhja dhe trajtimi i mbeturinave kërkon një harmoni dhe ekuilibër shoqëror e institucional, e cila nuk është lehtë e arritshme.

“Sot kemi një situatë me mangësi serioze në menaxhimin e mbeturinave. Kësisoj, ne mendojmë se ky sektor duhet të jetë prioritet i qeverisë. Me gjithë rolin e kufizuar, i cili pak a shumë është i kurrur në krijimin e politikave, ne kemi bërë e po bëjmë përpjekje që ta kalojmë këtë ngërç. Sot jemi këtu, së bashku me ministren e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, znj. Fitore Pacolli Dalipi, për ta shpallur një paketë të

emergjencës në fushën e mbeturinave, Aksionin Kundër Mbeturinave. Ky aksion ka për qëllim të arrijë dy efekte të njëkohshme. E para të intervenojë në vendet ku hedhja ilegale e mbeturinave rrezikon ambientin dhe shëndetin, po ashtu kërkon të shtrojë një rrugë të re, ku qeveria nuk rri më duarkryq, por është prijëse e organizimit dhe nxitjes së aktorëve që kanë përgjegjësi në fushën e mbeturinave”, ka thënë Kurti.



JONATHAN ANTIC... KUSH ËSHTË TRASHËGIMTARI 'FATAL' I MANGO-S, I ARRESTUAR PËR VDEKJEN E BABAIT TË TIJ?



Në faqen zyrtare të Mango-s, profili i Jonathan Andic shoqërohet me titullin e tij, nënkryetar i bordit drejtues dhe me një fotografi ku ai pothuajse buzëqesh.

Kjo foto bie në kontrast të plotë me pamjet që bënë xhiron e botës dje, ku djali i themeluesit të fuqishëm të kompanisë së veshjeve, Isak Andic, ecën me kokën ulur mes policëve.

Autoritetet, të cilat e konsideronin të dyshuar për vrasjen e të atit, i cili ra nga një humnerë 100 metra të thellë gjatë një ecjeje me djalin e tij më 14 dhjetor 2024 në malin Montserrat, dje proceduan me arrestimin e tij.

Arrestimi erdhi pas muajsh hetimesh nga policia për mbledhjen e provave, ndërsa gjyqtari i Martorellit që merret me çështjen urdhëroi paraburgimin e tij të

përkohshëm. Megjithatë, ai i dha mundësinë të mos kalojë asnjë ditë në burg duke caktuar një garanci prej 1 milion eurosh, kështu që djali i madh i njeriut që ndërtoi një perandori u largua i lirë, të paktën për momentin.

Familja Andic e mbështet plotësisht, pavarësisht akuzave të autoriteteve, dhe përmes përfaqësuesve të saj, sipas gazetës El País, deklaroi se është e bindur se “nuk ekzistojnë dhe nuk do të gjenden prova ligjore kundër tij” dhe se “pafajësia e tij është absolute”.

Megjithatë, asgjë nuk duhet konsideruar e sigurt për fëmijën që lindi në vitin 1981 dhe u rrit në një mjedis familjar që i ofroi gjithçka, edhe pse Mango ende nuk ekzistonte.

Gjatë rritjes, ai ndoqi disa shkolla, mes tyre internatin zviceran Beau Soleil, që

pranon nxënës nga 11 deri në 18 vjeç, i cili ndodhet në një lartësi prej 1.350 metrash në fshatin Villars-sur-Ollon. Më pas, Jonathan Andic studioi komunikim audioviziv në Amerikë dhe i përfundoi studimet në Spanjë, në IESE Business School në Barcelonë, duke u fokusuar në ekonomi dhe menaxhim biznesi.

Pavarësisht se prindërit e tij u divorcuan, ai ruajti marrëdhënie të ngushta me dy motrat e tij, Judith dhe Sara, si edhe me të ëmën, të cilat morën role të caktuara në kompani.

Por roli i tij ishte më i vështiri.

Pasardhësi, përgjegjësitë dhe konflikti

Djali i madh i Isak Andic hyri në Mango në vitin 2005 si

drejtues ekzekutiv, në moshën 24-vjeçare, duke kaluar gradualisht në departamente të ndryshme të kompanisë dhe duke punuar në dizajnin e koleksioneve, procesin krijues dhe menaxhim.

Pas dy vitesh përvoja, atij iu besua lançimi i koleksionit të parë për meshkuj të Mango-s dhe mbikëqyrja e zhvillimit të tij në mbarë botën. Ai punoi shumë dhe deri në vitin 2024 koleksionet mashkullore të kompanisë kishin 600 pika shitjeje në 90 tregje ndërkombëtare dhe kontribuonin me 12% të xhiros vjetore të perandorisë që nisi nga një dyqan në Barcelonë dhe arriti në 2 mijë e 700 dyqane në 110 vende.

Që nga viti 2012, pasardhësi ishte tashmë anëtar i bordit drejtues të kompanisë dhe në vitin 2014 mori drejtimin nga i ati, bashkë me përgjegjësitë.

Megjithatë, nuk i gëzoi për shumë kohë. Isak Andic ia hoqi praktikisht drejtimin e kompanisë, gjë që sipas mediave spanjolle shkaktoi një përplasje mes babait dhe birit, e cila vitet e fundit dukej se ishte shuar.

Por më pas erdhi ajo shëtitja fatale e fundit e babait dhe birit në shpellat e Montserratit dhe rënia e të parit nga një lartësi prej 100 metrash, që shkaktoi vdekjen e menjëhershme të miliardërit. Fillimisht u konsiderua aksident, por autoritetet konstatuan kundërshtime serioze në dëshmitë e trashëgimtarit dhe të martën në mëngjes proceduan me arrestimin e tij, duke hapur një kapitull të ri në çështje. Një kapitull për të cilin, të paktën për momentin, askush nuk e di se si do të përfundojë.

Policia britanike heton dy raste të reja të dyshuara të abuzimit seksual të lidhura me Jeffrey Epstein

Policia britanike ka nisur një hetim për dy raste të dyshuara të abuzimit seksual me fëmijë, pas publikimit të dokumenteve nga Departamenti i Drejtësisë i SHBA-së që lidhen me Jeffrey Epstein.

Sipas raportimeve njëri nga incidentet dyshohet se ka ndodhur në Surrey dhe


Berkshire në gjysmën e dytë të viteve '90, ndërsa rasti tjetër lidhet me një ngjarje të ndodhur në fund të viteve '80 në Surrey.

Autoritetet britanike theksuan se hetimet janë ende në fazë paraprake dhe nuk janë kryer arrestime.

“Ne i marrim seriozisht të gjitha raportet për krime

seksuale dhe po punojmë për të përcaktuar pistat e hetimit për të verifikuar informacionin ose për të krijuar prova”, deklaroi Policia e Surrey-t.

Hetimi vjen në kuadër të shqyrtimit më të gjerë të materialeve dhe dokumenteve që lidhen me rrjetin e dyshuar të abuzimeve të lidhura me Epstein.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Dukagjini dhe Ferizaj sonte përballen në finalen e Kupës së Kosovës

PRISHTINË, 20 MAJ - Sonte (e enjte) do të luhet finalja e Kupës së Kosovës në futboll. Do të përballen Dukagjini

dhe Ferizaj, skuadra që kërkojnë trofeun e parë të Kupës në histori të klubit. Kjo ndeshje do të zhvillohet nga

ora 21:00 në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Të dy ekipet synojnë paraqitje të fortë. Dukagjini do të kërkojë

ta shfrytëzojë formën dhe avantazhet e veta, ndërsa Ferizaj synon të befasojë dhe ta sigurojë fitojë kupën.



ZVICRA ME DY SHQIPTARË NË KUPËN E BOTËS



BERNË, 20 MAJ - Ekipi i Kombëtares së Zvicrës për Kupën e Botës, nën drejtimin e Murat Yakin, është finalizuar. Siç ishte paralajmëruar edhe më herët, lista nuk ka sjell surpriza, ndërsa pjesë e saj janë Granit Xhaka (Sunderland) dhe Ardon Jashari (Milan). Disa lojtarë të rinj dhe emra që kanë qenë në

formë të mirë kohët e fundit mbeten në listën e pritjes. Mes tyre përmenden Sascha Britschgi, Zachary Athekame, Alessandro Vogt dhe portieri Anthony Racioppi. Në gatishmëri janë edhe Alwyn Sanches dhe Joel Monteiro. Në ekipin e Zvicrës bëjnë pjesë edhe futbollistë të Thunit, kampionit të fundit, Ethan

Meichtry dhe Michael Heule, por mungon Kastriot Imeri. Zvicra do të mbledhet për stërvitje më 25 maj, ndërsa më 31 maj do të luajë një miqësore kundër Jordanisë në St. Gallen. Pas kësaj Zvicra do të udhëtojë drejt ShBA-së, në prag të nisjes së Kupës së Botës më 11 qershor.

ARSENALI SHPALLET KAMPION I ANGLISË

LONDËR, 20 MAJ - Pa e zhvilluar ndeshjen e fundit të sezonit, Arsenali është shpallur kampion i ri i Premierligës në Angli, pas 22 vjetësh pritjeje. Barazimi i Manchester Cityt, në udhëtim te Bournemouthi (1:1), ua ka mundësuar londinezëve ta festojnë para kohe titullin kampion. Me 82 pikë pas 37 ndeshjeve dhe katër më shumë se Manchester City, "Gunnars" e ka fituar titullin e kampionit, të cilin së fundi e kishte fituar në vitin e largët 2004, në

kohën e legjendave si Arsene Wenger trajner apo Thierry Henry, lojtari më i mirë i londinezëve. Ky është titulli i 14-t i Arsenalit në Angli, i fituar me shumë mund nga skuadra e Mikel Artetës, që kishte konkurrencë të fortë, me ekipin e mësuesit të tij, Pep Guardiola. City duhej të fitonte në këtë përballje dhe të shpresonte që në ndeshjen e fundit të fitonte me më shumë gola se Arsenali. Por, klubi është goditur nga

lajmi për largimin e Guardiols vetëm një natë më parë, që i jep fund një periudhe të jashtëzakonshme prej dhjetë vjetësh e Guardiols, si menaxher i Cityt. Arsenali do të ketë një periudhë feste, por edhe kohë për t'u përgatitur sa më mirë për finalen e Ligës së Kampionëve. Më 30 maj në Budapest, në Finalen e Madhe të garës prestigjioze, Arsenali luan kundër PSG-së, në kërkim të trofeut të parë evropian në histori të klubit.



MBAPPE LIDHET ME NJË TRANSFERIM TRONDITËS TE GJIGANTI ANGLEZ

MADRID, 20 MAJ - Ditët e Kylian Mbappes si lojtar i Real Madridit duket se po shkojnë drejt fundit dhe një gjigant i Premierligës mund të jetë stacioni i tij i radhës. Pas lënies mënjanë nga grupet e miqësisë brenda kampit dhe një pritjeje të ashpër nga tifozët, madje me një petition online që kërkon largimin e tij, Mbappe mund të jetë gati ta mbyllë kapitullin në "Santiago Bernabeu". "Special One" është raportuar në medie se ka identifikuar tashmë disa



figura të rëndësishme të klubit që duhet të largohen gjatë verës, në kuadër të një "pastrimi" të dhomave të zhveshjes, të cilat nuk kanë qenë kurrë më të përçara. Edhe pse jo domosdoshmërisht si pjesë e një qëndrimi publik të Mourinhos, një nga emrat që po flirtin me idenë e largimit nga "Bernabeu" është pikërisht Kylian Mbappe. Francezi aktualisht gjendet në mes të një "lufte" të vazhdueshme me Jude

Bellingham, me të dy lojtarët që u panë duke u përplasur në fushë pas një ndeshjeje ndaj Real Oviedos. Premierliga ka vetëm disa klube që realisht mund ta tërheqin Mbappen (dhe ta përballojnë pagën e tij), por me Manchester Cityn, Liverpoolin dhe Manchester Unitedi që pritet të investojnë fuqishëm këtë verë, pikërisht Chelsea po del favorite kryesore për firmën e tij. Më konkretisht, pas mbështetjes publike që i ka

dhënë në Real Madrid, raportet sugjerojnë se Xabi Alonso është i interesuar ta sjellë superyllin francez në "Stamford Bridge". Mbappe kishte shënuar 30 gola në 28 ndeshje nën drejtimin e Alonsos, ndërsa ritmi i golave raportohet se është zbehur disi që prej ardhjes së Arbeloas (12 gola në 18 ndeshje). Sulmuesi 27-vjeçar më herët kishte shprehur publikisht pakënaqësinë për largimin e Alonsos nga Madridi.

Chivu vazhdon me Interin deri në vitin 2028

MILAN, 20 MAJ - Christian Chivu do të mbetet pjesë e Interit edhe për disa vjet të tjera. Klubi "zikaltër" ka arritur marrëveshje për vazhdimin e kontratës së trajnerit deri në qershor të vitit 2028, me

opsion rinovimi edhe për një sezon shtesë deri më 2029. Pas një edicioni fantastik, ku Interi ka fituar titullin kampion në Serinë A dhe ka triumfuar edhe në Kupën e Italisë, drejtuesit e klubit kanë

vendosur ta shpërblejnë Chivun me kontratë të re dhe rritje të ndjeshme të pagës. Trajneri rumun ka marrë drejtimin e skuadrës në një moment delikat, por ka arritur ta rikthejë Interin në majat e

futbollit italian, duke fituar besimin e klubit dhe tifozëve. Vazhdimi i bashkëpunimit konsiderohet hap i rëndësishëm për stabilitetin e projektit zikaltër në vitet e ardhshme.





KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të Kryeshefes Ekzekutive të datës 15.05.2026 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M. "Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 21.05.2026 të shpall:

KONKURS PUBLIK

Faturist/e- në Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 15-05-229

Përgatitja profesionale: Përgatitje Universitare (Fakulteti Ekonomik i preferuar)

Përvoja e punës: Së paku një (1) vit përvojë pune

Lartësia e pagës mujore: 474.94 € Bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bëni llogaritjen dhe shtypjen e faturave sipas shenimeve dhe çmimeve valide të sektorit të amvisërisë dhe sektorit komercial.
- Mban evidencën mbi ndryshimet dhe specifikacionet nga fushëveprimtaria e punëve dhe detyrave të punës, si dhe dëshminë mbi dorzimin e faturave manipulante për procedurë të mëtejme (Dërgimin e faturave blerësve),
- Regjistron, udhëheq analitiken e blerësve nga arka në terene (inkasantave) dhe ekstraktet bankare, kryen edhe punë tjera sipas urdhërimit të eprorit drejtëpërdrejtë.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i KRM "Uniteti" Sh.A-Mitrovicë
- Cv- në
- Dëshmi për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Dëshmi për përvojën e punës
- Kopja e leternjoftimit,
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e çertifikatës/ekstratit të lindjes,
- Dëshmi nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj).

Një (1) Punëtor Fizik- Njësia në Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 15-05-229

Përgatitja profesionale: Diploma e shkollës fillore ose të mesme e preferueshme

Lartësia e pagës mujore: 496.65 € Bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor;
- Zbrazen e kontejnerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi;
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve;
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në kontejner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit;
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të kontejnerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejtë.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i KRM "Uniteti" Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e leternjoftimit,
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e çertifikatës/ekstratit të lindjes,
- Dëshmi nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj).

Një (1) Inkasant- Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 15-05-229

Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme

Lartësia e pagës mujore: 464.33 € Bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bëni inkasimin e mjeteve në bazë të faturave me të cilat ngarkohet materijalisht;
- Bëni zbulimin - regjistrimin me kohë të sipërfaqeve të reja dhe të përgjithshme;
- Përcjell ndryshimet apo ndërrimet e sipërfaqeve dhe ndryshimet tjera të nevojshme në sektorin e amvisërisë respektivisht komercial duke e njoftuar Shërbimin e faturimit;
- Dorzimin ditor të pazarit nga faturat e inkasuara;
- Përgjegjësi materjale dhe penale për faturat e inkasuara si dhe përgjegjësi në punë;
- Realizimi i normativit të inkasimit i përcaktuar sipas planit të punëdhënësit;
- Kryen edhe punë të tjera të kësaj natyre sipas urdhërësës së eprorit të drejtëpërdrejtë.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i KRM "Uniteti" Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e leternjoftimit,
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e çertifikatës/ekstratit të lindjes.

Një (1) Vozitës i kategorisë "C"- Njësia në Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 15-05-229

Përgatitja profesionale: Shkolla e mesme

Lartësia e pagës mujore: 542.89 € Bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas Urdhërësës së Punës drejton automjetin dhe kujdeset për rregullësin, higjienën dhe pastërtin e tij;
- Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikase dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.;
- Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona), tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit-kryepunëtorit;
- Para daljes në teren merr Urdhërësen e Punës në të cilën evidencen punët e kryera , vërejtejt mbi pengesat dhe defektet në automjet, dhe të njejtën e kthen te dispeçeri;
- Vendos (monton) letrën e re të tahografit ndërsa letrën paraprake e kthen te dispeçeri, brenda 12 orëve;
- Vozitësi i cili e monton letrën e tahografit ka obligim që në të shënon: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhën fillestare dhe përfundimtare;
- Është i obliguar që në automjet të ketë mjetet e nevojshme të punës (lopatat, fshisat etj.), për ekipen e punëtorëve me të cilët punon, largon (bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhërësen e punës;
- Në rast nevojë ndrron gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomisterin;
- Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë t'i lajmnron me shkrim të udhëheqësi i drejtëpërdrejtë dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes;
- Çdo sjellje të pandërgjegjësme të punëtorëve me të cilët punon vozitësi është i obliguar që ta paraqet te udhëheqësi drejtëpërdrejtë;
- Vozitësi e njofton kryepunëtorin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim;
- Është i obliguar që në Deponi të mbeturinave tu përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi;
- Nëse automjeti me të cilin punon ndodhet në prishje apo jashtë planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjetin tjetër, dhe të kryen punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit drejtëpërdrejtë, nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjes;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i KRM "Uniteti" Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e patentë Shoferit kategoria "C",
- Kopja e leternjoftimit,
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e çertifikatës/ekstratit të lindjes,
- Dëshmi nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj).

Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit.

Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjatë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës).

Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Kandidatët fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë ne çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njejtja të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Afati dhe mënyra e Aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njejtin në gazeta ditore, dhe atë nga data 21.05.2026 deri me 04.06.2026, ora 16:00.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M. "Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr. "Vëllëzrit Dragaj" p.n. çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Dorzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: krmuniteti@yahoo.com

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të parapara nuk pranohen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "A&G Partners" Sh.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 812296946 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "A&G Partners" D.O.O. od Gjakovica, donelo odluku o prestani rada sa nrB. 812296946 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "A&G Partners" L.L.C. with headquarters Gjakova, has come to the decision to quit its business: 812296946 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shpejtim Makshana shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Jetulla Krasniqi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Arjana Kukaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Leke Dukagjini" Prizren.

- Sabit Ferati shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Valentina Avdijaj nga Skivjani shpall të pavlefshme për herë të dytë diplomën e humbur dhe dëftesën e plotë të shkollës fillore "Ukshin Miftari", Skivjan-Gjakovë.

- Çlirim Gjurar nga Gërqina e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U "7 Shtatori", nga klasa e 6-9.

- Fitim Sylja shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. "7 Shtatori" Prishtinë.

- Vilson Gjyckaj nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U "Engjëll Gjoni", Novosellë, nga klasa 1-8.

- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë "Hyni Zajmi" Gjakovë.

- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit "Fehmi Agani" Baçelor i Edukimit Fillor.

- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Selman Riza" Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.

- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Veton Muhadri shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë si dhe dëftesat e kl. 10.11.12. - Beqir Cenaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Bedri Smolica shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Buna Sada shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Albrim Sylja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Selman Riza" Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

